

**RELACION SHPJEGUES PËR PROJEKTVENDIMIN
“PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR QËLLIME TË SIGURISË,
QËNDRUESHMËRISË DHE SAKTËSISË NË REGJISTRIMIN E TË
DHËNAVE PËR “DOMAIN-NAMET.AL””**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti “Për miratimin e rregullave për qëllime të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe saktësisë në regjistrimin e të dhënave për “domain-namet.al”, vjen si propozim i Ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 133 të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me pikën 34, të nenit 5 të ligjit Ligjit Nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”.

Ky projektakt ka për qëllim të miratojë rregullat për qëllime të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe saktësisë në regjistrimin e të dhënave për “domain-namet.al”. Projektakti ka si qëllim plotësimin e kuadrit nënligjor që del i nevojshëm në zbatim të Ligjit Nr.54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është parashikuar në Planin Analitik të akteve për vitin 2025, dhe do të parashikohet në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2025 – 2027, i cili është në proces përgatitje. Projektvendimi lidhet me zbatimin e ligjit Nr.54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë ” si dhe me parashikimet e ligjit Nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji Nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka transpozuar Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike”, në pikën 3 të nenit 133, ka parashikuar miratimin e rregullave për qëllime të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe saktësisë në regjistrimin e të dhënave për domain-namet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Me anë të projektvendimit “Për miratimin e rregullave për qëllime të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe saktësisë në regjistrimin e të dhënave për “domain-namet.al” synohet përafrimi i pjesshëm i nenit 27 dhe 28 të Direktivës (BE) nr. 2022/2555, në lidhje me kërkesat për sigurinë, qëndrueshmërinë dhe saktësinë në regjistrimin e të dhënave për “domain-namet.al”.

Miratimi i këtyre rregullave është në përputhje me parashikimin e pikës 3, të nenit 133 të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të pikës 34, të nenit 5 të ligjit Ligjit Nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”.

Në kuadër të miratimit të ligjit Nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”, i cili ka transpozuar në tërësi Direktivën (BE) nr. 2022/2555, nuk janë përfshirë nenet 27 dhe 28, të saj të cilat janë parashikuar me akt nënligjor në zbatim të ligjit për komunikimet elektronike.

Miratimi i këtyre rregullave do të shërbejë për rritjen e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe saktësisë në regjistrimin dhe mbajtjen e të dhënave për domain-namet që regjistrohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga AKEP në përputhje me parashikimet në ligjin për komunikimet elektronike.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 133 të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, “Për miratimin e rregullave për qëllime të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe saktësisë në regjistrimin e të dhënave për “domain-namet” si dhe parashikimet e pikës 34, të nenit 5 të ligjit Ligjit Nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky vendim është përafruar pjesësisht me direktivën (BE) nr. 2022/2555, të Parlamentit dhe Këshillit, datë 14 dhjetor 2022, “Mbi masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë kibernetike në të gjithë Bashkimin Evropian, e cila ka ndryshuar rregulloren (BE) nr. 910/2014 dhe direktivën (BE) nr. 2018/1972, si dhe ka shfuqizuar direktivën (BE) nr. 2016/1148.

Përmes këtij projektakti bëhet përafrimi i pjesshëm i nenit 27 dhe 28 të Direktivës (BE) nr. 2022/2555, në lidhje me kërkesat për sigurinë, qëndrueshmërinë dhe saktësinë në regjistrimin e të dhënave për “domain-namet.al”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektakti përmban dy nene ku me nenin 1, miraton dokumentin që përcakton rregullat për qëllime të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe saktësisë në regjistrimin e të dhënave për “domain-namet. al”, dhe me nenin 2, përcakton autoritetet përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të tij.

Dokumenti bashkëlidhur projektvendimit që përcakton rregullat për qëllime të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe saktësisë në regjistrimin e të dhënave për “domain-namet .al”, është i organizuar me 14 pika si më poshtë:

Në pikën 1, parashikohet që AKEP krijon dhe mban regjistrin e emrave të domain-eve me nivel të lartë “.al” ose “regjistrin e emrave të domain-eve TLD.al” si dhe të subjekteve që ofrojnë shërbime të regjistrimit të emrit të domain-it.

Ky përcaktim bën përafrim të pjesshëm me paragrafin e parë të nenit 27 të Direktivës (BE) nr. 2022/2555 dhe bazohet në parashikimet e nenit 12, të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të pikës 34, të nenit 5 të ligjit Nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”. Gjithashtu ky formulim vjen në vijimësi të detyrave që AKEP ka pasur dhe me ligjin nr. 9918 date 19.5.2008 Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar që u zëvendësua me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 54/2024.

Në pikat 2, 4 deri në 14, bëhet përafrimi i plotë i nenit 28 të Direktivës (BE) nr. 2022/2555 në lidhje me kërkesat për garantimin e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe saktësisë në regjistrimin e të dhënave për domain-namet “.al” duke përcaktuar se çfare duhet të përmbajë regjistri i AKEP sipas pikës 1, dhe saktësuar që përmban emrat e domain-eve (dhe nëndomain-eve) ccTLD.al, emrat e domain-eve të internetit të regjistruar në Republikën e Shqipërisë me prapashtesën “.al”, të dhënat e poseduesve të tyre, historikun e veprimeve me domain-et me “.al” dhe sistemin ccTLD.al.

Rregullat përcaktojnë që AKEP mbledh dhe mban të dhëna të sakta, të plota të regjistrimit të emrit të domain-it në një regjistër të dedikuar duke respektuar ligjin e mbrojtjes së të dhënave në lidhje me të dhënat personale.

Gjithashtu parashikohet që regjistri do të përmbajë informacionin e nevojshëm për të identifikuar dhe kontaktuar mbajtësit e emrave të domain-it “.al” si dhe pikat e kontaktit që administrojnë emrat e domain-eve “cc.TLD.al”. detyrimin për të informuar për pikat e kontaktit si dhe çdo ndryshim që në të dhënat e raportuara në çdo rast jo më vonë se tre muaj nga data e ndryshimit.

Me qëllim rritjen e sigurisë në pikën 7 kërkohet që AKEP dhe subjektet e autorizuar nga AKEP për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit të emrit të domain-it “.al”, miratojnë politika të sigurisë dhe procedurat, përfshirë procedurat e verifikimit për të siguruar që regjistri i përmendur në pikën 1, të këtij neni përfshin informacion të saktë dhe të plotë.

Gjithashtu kërkohet që politikat e sigurisë dhe procedurat e miratuara të publikohen në faqen e internetit të AKEP. Kërkohet që subjektet që zbatojnë dhe përshtasin masat e sigurisë së sistemit teknik të administrimit të domainit “.al”, me shpenzimet e tyre dhe brenda afateve të përcaktuara nga AKEP.

Në përputhje me parashikimet e nenit 28 të NIS2 parashikohet që regjistri me emrat ccTLD.al si dhe subjektet që ofrojnë shërbime të regjistrimit të emrave të domain-it përgjigjen brenda 72 orëve nga marrja e kërkesës. Parashikohet që në zbatimin e këtyre rregullave AKEP do të bashkëpunojë me AKSK si dhe subjektet që ofrojnë shërbime të regjistrimit të emrave të domain-it.

Administrimi i domain nameve “.al” dhe nëndomaineve “.al” është një detyrë që AKEP e ka në vijimësi që nga viti 2006 dhe në ligjin nr. 54/2024 janë ruajtur rregullimet që ekzistonin në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008 “Per komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar. Në pikën 3 të rregullave është parashikuar që kostot për krijimin, funksionim, mirëmbajtjen dhe sigurinë e regjistrimit të emrave të domaineve “.al”, përballohen nga pagesat që kryhen në AKEP për regjistrimin e emrave të domaineve, pagesat e subjekteve të autorizuar për regjistrim domainesh me “.al” dhe burime të tjera të ligjshme. Ky përcaktim është në përputhje me rregullimet ligjore ekzistuese për administrimin e domain nameve nga AKEP.